



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. <u>20/DPK</u>	Nr Prot. Br Prot. <u>01-4976/15</u>
Nr l faq. Broj stranica <u>02</u>	Data Datum <u>31.12.2015</u>
Nr. pages	Datë
	<small>D. SHITINE</small>



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 31.12.2015, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-3964/14, për z. Mensur Beqiri, ish Drejtor i Drejtorisë për Mirëqenie Sociale dhe Integritet Evropiane në Komunën e Mitrovicës, për shkak se nuk ka të dhëna të mjaftueshme që argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funkcionit Publik për zyrtarin e lartë, z. Mensur Beqiri, ish Drejtor i Drejtorisë për Mirëqenie Sociale dhe Integritet Evropiane në Komunën e Mitrovicës, dhe njëkohësisht, person i autorizuar në një biznes privat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.

Në rastin e lartpërmendur, zyrtari i lartë z. Beqiri është hetuar për situatë të konfliktit të mundshëm të interesit në ushtrimin e funksionit publik. Pas analizimit të gjendjes është konstatuar se z. Beqiri nuk ushtron më funksion publik, kjo është vërtetuar me pranimin formularit të deklaramentit të pasurisë pas përfundimit të funksionit.

Duke u bazuar në Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit konsiderojmë se nuk kemi situatë të shkeljes së dispozitave të këtij Ligji, zyrtari i lartë pas përfundimit të funksionit publik, mund të ushtrojë funksion menaxhues në biznes privat, prandaj pushojnë hetimet për Konflikt Interesi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znoj. (zyrtari përgjegjës)

Hasan Preteni
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

